



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-153

Prishtinë, më 14 prill 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 14 prill 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca, Petar Miletiq dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 prill 2014,
2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 prill 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 prill 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 7 prill 2014.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare, të filluar më 10 prill 2014:

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 17 prill 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë eksportuese, e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit “Modernizimi i sistemit të arsimit të edukimit në Kosovë nëpërmjet e-edukimit”,*
2. *Votimi i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,*
3. *Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës.*

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 17 prill 2014, në orën 10:30, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komisionarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës,*
- 5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,*
- 6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, dhe*
- 7. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

- 1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Kroaci*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetit Burim Ramadani për të marrë pjesë në konferencën me temë: “Parlamentet dhe shoqëria civile në Evropën Juglindore/partner apo kundërshtar”, që do të mbahet në Kroaci, më 25-27 prill 2014.
2. Shpenzimet e udhëtimit mbulohen nga organizatori, ndërsa mëditjet për të lartshënuarin në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Pikat shtesë:

- 1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës*

Projektligjin e lartpërmendur, Kryesia e radhiti në rend të ditës për mbledhjen plenare të radhës.

2. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës në Kosovë të delegacionit nga Komisioni për Harmonizim me BE-në në Kuvendin e Madh të Turqisë
Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Integritet Evropian të Kuvendit të Kosovës për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës të delegacionit nga Komisioni për Harmonizim me BE-në në Kuvendin e Madh të Turqisë, në Kosovë, më 20-22 prill 2014.
2. Të gjitha shpenzimet e qëndrimit në Kosovë të delegacionit nga Komisioni për Harmonizim me BE-në në Kuvendin e Madh të Turqisë mbulojnë nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*